

## BELIND KËLLIÇI



**Datëlindja:** 25.1.1987

**Vendlindja:** Tiranë

**E-mail:** Belind.Këlliçi@parlament.al

### **Jetëshkrimi:**

Ka lindur në Tiranë më 25 janar 1987. Ka kryer studimet universitare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në universitetin *Coppin State University*, ku është diplomuar për shkencë menaxhimi me vlerësimin “*Summa Cum Laude*” dhe në përfundim të studimeve është shpallur “Studenti me mesataren më të lartë në diplomim”. Për shkak të rezultateve të larta akademike në SHBA, prej vitit 2008 është anëtar i “*Sigma Beta Delta*”, *International Honors Society in Business, Management and Administration*.

Ka mbajtur detyra të ndryshme si Kordinator për FIA-n dhe ARC Europë (2008-2009), drejtor në Agjencinë Kombëtare të Turizmit (2009-2011), si dhe përgjegjës sektori në Drejtorinë e Artit dhe Kulturës në Bashkinë e Tiranës (2011-2015).

Karrierën politike e ka nisur shumë herët si anëtar i Forumit Rinor të Partisë Demokratike, anëtar i thjeshtë i PD-së dhe më pas është zgjedhur anëtar i Këshillit Kombëtar të PD-së.

Në tetor të vitit 2014 është emëruar Koordinator Kombëtar, ndërsa në nëntor të vitit 2014 zgjidhet nga Këshilli Kombëtar i PD-së si drejtor i Departamentit të ish të Përndjekurve dhe Pronarëve, duke mbajtur rrjedhimisht edhe pozicionin e anëtarit të kryesisë në Partinë

Demokratike. Në dhjetor të vitit 2015 është zgjedhur kryetar i Forumit Rinor të Partisë Demokratike.

Ka kryer edhe një sërë aktivitete dhe trajnimesh brenda dhe jashtë vendit, si: pjesëmarrës në “Politikat dhe fushat politike të qendrës së djathtë” *International Republican Institute*, Tiranë; “Teknikat dhe metodologjia për zhvillimin e fushave politike” Mal i Zi, si dhe pjesëmarrës në shkollën verore “Principet për një shoqëri të lirë”.